

# Qëndrimet e kosovarëve lidhur me pushimin prindëror për prindin baba



Pyetja është shtruar për ta kuptuar qëndrimin e përgjithshëm të qytetarëve nëse mendojnë që prindi baba duhet të gëzojë pushim prindëror. Mënyra se si është frazuar pyetja është bërë me qëllim të largimit të dilemave financiare dhe profesionale, për ta kuptuar më mirë qëndrimin lidhur me pushimin prindëror për prindin baba.

Në këtë publikim të shkurtër janë paraqitur në formë tabelare përgjigjet e qytetarëve duke pasur paraqysh gjininë, punësimin, edukimin, moshën, vendbanimin dhe të ardhurat personale.

## Shënim lidhur me mbledhjen e të dhënave:

Pyetja e shtruar më sipër është shpërndarë si pjesë e anketës omnibus të kryer nga UBO Consulting në muajin qershor 2023. Mostra është reprezentative me 1065 respondentë. Në tabelat e paraqitura, totalët kumulative mund të mos rezultojnë gjithmonë deri në 100%. Kjo mospërputhje i atribuohet rrumbullakësimit të vlerave për qëllime qartësie dhe prezantimi. Ndërsa numrat rrumbullakosen në pikën e plotë ose dhjetore më të afërt, mund të ndodhin ndryshime të vogla në shumën totale. Është e rëndësishme të theksohet se këto dallime rrumbullakësi janë minimale dhe nuk ndikojnë në interpretimin ose saktësinë e përgjithshme të të dhënave.

?

## Instituti për Politika Sociale Musine Kokalari ka pyetur qytetarët e Kosovës:

“Nëse nuk do të kishit pasoja në vendin tuaj të punës (shkëputje e kontratës ose largim nga puna) dhe nëse qeveria do ta përkrahte financiarisht pushimin prindëror, a besoni se baballarët duhet të marrin 4 deri 6 muaj pushim prindëror dhe të qëndrojnë në shtëpi në vitin e parë të jetës së foshnjës së tyre?”

PËRKRAHUR NGA:



TABELA 3

## Edukimi

?

“Nëse nuk do të kishit pasoja në vendin tuaj të punës (shkëputje e kontratës ose largim nga puna) dhe nëse qeveria do ta përkrahte financiarisht pushimin prindëror, a besoni se baballarët duhet të marrin 4 deri 6 muaj pushim prindëror dhe të qëndrojnë në shtëpi në vitin e parë të jetës së foshnjës së tyre?”

Përgjigjia	Disa vite të shkollës fillore	Shkolla fillore	Disa vite të shkollës së mesme	Shkolla e mesme	Student	Fakultet	Master, Magjistraturë dhe/ose Doktoraturë	Total
Po	52.5%	61.5%	86.4%	72.5%	81.2%	77.5%	83.3%	72%
Jo	30%	25.3%	13.6%	20.1%	8.7%	19.1%	8.3%	20%
Nuk e di/ Refuzoj të përgjigjem	17.5%	13.2%	0%	7.4%	10.1%	3.3%	8.3%	8%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

TABELA 4

## Mosha

?

“Nëse nuk do të kishit pasoja në vendin tuaj të punës (shkëputje e kontratës ose largim nga puna) dhe nëse qeveria do ta përkrahte financiarisht pushimin prindëror, a besoni se baballarët duhet të marrin 4 deri 6 muaj pushim prindëror dhe të qëndrojnë në shtëpi në vitin e parë të jetës së foshnjës së tyre?”

Përgjigjia	>24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	Totali
Po	79.5%	75.1%	75.5%	66.3%	65.5%	59.3%	72.1%
Jo	14%	21.3%	18.5%	21.5%	22.7%	25.9%	19.9%
Nuk e di/ Refuzoj të përgjigjem	6.5%	3.6%	6%	12.3%	11.8%	14.8%	8%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

TABELA 5

## Vendbanimi

?

“Nëse nuk do të kishit pasoja në vendin tuaj të punës (shkëputje e kontratës ose largim nga puna) dhe nëse qeveria do ta përkrahte financiarisht pushimin prindëror, a besoni se baballarët duhet të marrin 4 deri 6 muaj pushim prindëror dhe të qëndrojnë në shtëpi në vitin e parë të jetës së foshnjës së tyre?”

Përgjigjia	Urban	Rural	Totali
Po	71.2%	72.7%	72%
Jo	20.3%	19.6%	19.9%
Nuk e di/Refuzoj të përgjigjem	8.5%	7.8%	8.1%
Total	100%	100%	100%

TABELA 6

## Të hyrat personale



“Nëse nuk do të kishit pasoja në vendin tuaj të punës (shkëputje e kontratës ose largim nga puna) dhe nëse qeveria do ta përkrahte financiarisht pushimin prindëror, a besoni se baballarët duhet të marrin 4 deri 6 muaj pushim prindëror dhe të qëndrojnë në shtëpi në vitin e parë të jetës së foshnjës së tyre?”

Përgjigjia	Deri 150 euro	151-300 euro	301-450 euro	451-600 euro	601-750 euro	751-900 euro	Mbi 900 euro	Nuk kam realizuar fare të ardhura	Pa përgjigje	Totali
Po	79.5%	75.1%	75.5%	66.3%	65.5%	59.3%	72.1%	79.5%	75.1%	75.5%
Jo	14%	21.3%	18.5%	21.5%	22.7%	25.9%	19.9%	14%	21.3%	18.5%
Nuk e di/ Refuzoj të përgjigjem	6.5%	3.6%	6%	12.3%	11.8%	14.8%	8%	6.5%	3.6%	6%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Është me rëndësi të theksohet që ky publikim është i kufizuar vetëm me një pyetje dhe se është e vështirë të kuptohet konteksti më i gjerë i qëndrimeve të qytetarëve lidhur me këtë temë bazuar në vetëm një pyetje. Një hulumtim i veçantë për t'i kuptuar thellësisht qëndrimet mbi përkujdesin ndaj fëmijëve dhe rolin e prindërve është i nevojshëm, për të diskutuar ndryshime dhe ndërrhyrje në politikën sociale në Kosovë.

Duke u bazuar në këtë anketë, 72.2% e respondentëve miratuan idenë që baballarët të qëndrojnë në shtëpi me fëmijën e tyre për 4-6 muaj në vitin e parë të lindjes, me kusht që të mos ketë kufizime karriere apo financiare. Ky rezultat është një tregues i rëndësishëm për hartimin e politikave sociale që ndërlidhen me pushimin e lehonisë, pushimin prindëror, politikën e punësimit dhe mbrojtjes sociale, shëndetësore dhe të pensionimit.

Këto rezultate theksojnë nevojën për ndryshime politikash dhe mbështetje shoqërore për të mundësuar dhe inkurajuar baballarët të marrin lejen prindërore. Kjo për të nxitur lidhje më të forta midis baballarëve e fëmijëve dhe potencialisht duke rritur mundësitë e punësimit të grave duke reduktuar barrën e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët mbi to.

Rezultatet e anketës theksojnë qartë pranimin e gjerë të baballarëve që marrin një rol më aktiv kujdestar gjatë vitit të parë të fëmijës në Kosovë. Nuk është vetëm një çështje zgjedhjeje, por një e drejtë themelore që duhet inkurajuar dhe mbështetur në mënyrë aktive.

Mundësimi i lejës prindërore për baballarët dhe inkurajimi për shfrytëzimin e kësaj të drejte promovon barazimin gjinor dhe rrit perspektivat e grave në edukim dhe punësim, duke reduktuar barrën tradicionale të kujdesit.



PUBLIKUAR MË: Nëntor 2023

HULUMTIMI I REALIZUAR MË: Qershor 2023

*Të dhënat e siguruara në këtë hulumtim janë donacion nga UBO Consulting për IPS Musine Kokalari.*

Dizajnimi i këtij publikimi është financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar / Swedish International Development Cooperation Agency. SIDA nuk ndan domosdoshmërisht pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë publikim. Përgjegjësia për përmbajtjen i takon IPS Musine Kokalari.

